



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 34 prot.

Kamëz, më 16.03.2021

VENDIM

Nr. 29 .Datë 16 /03 2021

PËR

NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 167, DATË 23.12.2020

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 16.03.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt – Vendimin Nr.26 Datë 11.03.2021**, mbështetur në Ligjin në nenin 54 të Ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006," "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, "Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014, "Për Planifikimin e Territorit" i ndryshuar, VKM nr.408 datë 13.05.2015, "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar,udhëzimin nr. 9, datë 26.02.2008 për "Tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme" (indryshuar); VKM 626, datë 15.07.2015"Për miratimin e normative të projektimit të banesave", **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në VKB nr.167, datë 23.12.2020, si më poshtë vijon:
2. Pika A5 e VKB-së nr.167, datë 23.12.2020:

ishte:

1. . Baza e taksës është vlera në lekë sipas preventivitqë kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejës së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) % të çmimit të shitjes për metër katror.

Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate konçensionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit Ndërtesa (me shume se familjare) duke përfshirë fabrika dhe magazina.

Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njërive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të



vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kostos mesatare të banesave të ndërtimit, të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është:

a) Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë individ apo me sipërmarrës; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndërtimit në infrastrukturë është në masën 3 % të vlerës së investimit,

b) për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombetare, të porteve, areporteve, tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji , përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit ,por jo më pak se kostoja e reabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto e reabilitimit nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

c) për ndërtesat , të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimive të reja është 0.5% e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet pasi të jetë vertetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi.

Shënim: Për Aktin Normativ Nr.3, datë 2.10.2019 për disa shtesa ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar Neni 1. pas pikes 8,të nenit 27, shtohet pika 9 me këtë përmbajtje. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimet e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasoje e fatkesësive natyrore, të përcaktohen me "Vendim të Këshillit të Ministrave ", neni 36/1 Dispozitë tranzitore, për sa më sipër të datës 21 shtator 2019, përfshihen nga detyrimi për pagesën e taksën e taksës së ndikimit në infrastrukturë".

Shënim: Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marketregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".

Shënim: Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

Shënim: Autoriteti vendor i planifikimit nuk e paguan taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për zhvillimet e veta me fonde publike.

Baza e taksës: Niveli taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

Detyrimi dhe kështu e pagimit: Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit te Territorit dhe Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit.

bëhet :

1. Baza e taksës është vlera në lekë sipas preventivit që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejës së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 përqind të çmimit të shitjes për metërkatror të sipërfaqeve të shfrytëzueshme*.

Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njërive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas përcaktimeve të udhëzimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e koston mesatare të banesave të ndërtimit, të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

- I. Çmimi për 1 m² sip. Ndërtimi për banim, është çmimi i shitjes në vlerën referuese të vlerës së tregut sipas zonave.
- II. Çmimi për 1 m² sip. Ndërtimi për dyqane mallrash apo shërbimesh është 1.5 herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas zonave.
- III. Çmimi për 1 m² sip. Ndërtimi për garazh të mbuluar është 70 përqind e çmimit të sipërfaqeve së apartamenteve të banimit sipas zonave.
- IV. Çmimi për 1 m² sip. Ndërtimi zyra është i njëjtë me çmimin e sip. të apartamenteve.

Llogaritja e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për godina banim dhe shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit:

- Parkimet (katet nëntokë): Llogaritja e sipërfaqes së shfrytëzueshme e parkimeve nëntokësore të mbuluara bëhet duke hequr nga sipërfaqja totale e ndërtimit rrugët qarkulluese në parkim, kafazet e ashensorëve dhe të shkallëve, ambjente të ndryshme ndihmëse ose teknike, rampa hyrëse në parkim)
- Sipërfaqja e planit 0.00: Nga sipërfaqja totale e ndërtimit heqim kafazet e ashensorëve dhe të shkallëve, ambjente të ndryshme ndihmëse ose teknike, koridor i/et i/e hyrje kryesore, kabina elektrike)
- Sipërfaqet e kateve mbi 0.00: Nga sipërfaqja totale e ndërtimit heqim kafazet e ashensorëve dhe të shkallëve, koridoret, si dhe taracat e tërheqjeve për efekt të kondicioneve urbane të përcaktuara në (pdv ose lejet e zhvillimit të miratuar).
- Dalja e kafazit të shkallëve dhe tarraca e katit të fundit nuk merren në llogaritje.

***sipërfaqe e shfrytëzueshme – përkufizimi sipas vendimit nr.626, datë 15.7.2015
"Për miratimin e normativave të projektimit të banesave".**

3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është:

a) Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë individi



apo me sipërmarrës; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndërtimit në infrastrukturë është në masën 3 % të vlerës së investimit,

b) për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombetare, të porteve, areporteve, tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji , përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit ,por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto e rehabilitimit nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

c) për ndërtesat , të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimive të reja është 0.5% e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet pasi të jetë vertetur pagesa e taksës nga taksapaguesi.

Llogaritja e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet të ndryshme nga pika 2.

Në rastin e ndërtimeve ndryshme nga pika 2. niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet të reja është **3 për qind e vlerës së investimit**. Vlera e investimit llogaritet sipas koston mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar Banesave ose preventivin e investimit të paraqitur nga subjekti i interesuar dhe përzgjidhet vlerën më të lartë midis të dyjave.

Llogaritja e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për banesa individuale, godina industriale, ekspozita, agro-biznes/turizëm, hoteleri, karburante, bar-restorante, struktura magazinimi/prodhimi, qendra sociale/kulturore/kulti, telefoni, shërbime sociale, kopshte, çerdhe, komplekse spitalore, komplekse sportive/pishina, rikonstruksione, mur rrethues, etj.

- Sipërfaqja mbi të cilën llogaritet taksa e ndikimit në infrastrukturë është sipërfaqja totale e ndërtimit e këtyre objekteve, (nëse objektet kanë veranda, në sipërfaqen e totale të ndërtimit nuk merret sipërfaqja e verandës/ave).
- Vlera referencës së objektit sipas koston mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave krahasohet me preventivin e investimit të paraqitur nga subjekti i interesuar dhe përzgjidhet vlerën më të lartë midis të dyjave.
- Për objekte të cilat nuk kanë vlerë referencë të miratuar (muri rrethues, pishina, rikonstruksion) niveli i taksës merret mbi preventivin e investimit të paraqitur në kërkesës.

***sipërfaqe e shfrytëzueshme – përkufizimi sipas vendimit nr.626, datë 15.7.2015**

“Për miratimin e normativave të projektimit të banesave” .

Shënim: Për Aktin Normativ Nr.3, datë 2.10.2019 për disa shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar Neni 1. pas pikes 8, të nenit 27, shtohet pika 9 me këtë përmbajtje. Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimet e ndërtesave të destinuara për qëllime banimi, të dëmtuara si pasojë e fatkesësive natyrore, të përcaktohen me "Vendim të Këshillit të Ministrave ", neni 36/1 Dispozitë tranzitore, për sa më sipër të datës 21 shtator 2019, përfshihen nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë".



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Shënim: Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtur të një marketregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".

Shënim: Përjashtohen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të çertifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.

Shënim: Autoriteti vendor i planifikimit nuk e paguan taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për zhvillimet e veta me fonde publike.

Baza e taksës: Niveli taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

Detyrimi dhe kështu e pagimit: Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Per zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Finances dhe Kontabilitetit.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Nën/ Kryetar Këshilli

Ali Dauti

